

V E N D I M
Nr.238, datë 10.4.2003

PËR LICENCIMIN E VEPRIMTARISË PRIVATE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, shkronja “a” të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor” dhe të nenit 43 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat juridikë, vendas ose të huaj, që do të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shëndetësisë, duhen të pajisen me licencë nga komisioni i posaçëm për dhënien e licencave, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Veprimtaritë që licencohen nga ky komision janë:

- a. Tregtimi me shumicë e pakicë, eksport-import i barnave.
- b. Tregtimi me shumicë e pakicë, eksport-import i materialeve me përdorim mjekësor.
- c. Hapja e kabineteve dhe e klinikave dentare.
- ç. Hapja e qendrave diagnostikuese, kabineteve mjekësore, klinikave mjekësore dhe laboratorëve mjekësorë.
- d. Hapja e klinikave optike dhe e laboratorëve optikë.
- dh. Ushtrimi i veprimtarisë së lirë mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra nga Ministri i Shëndetësisë (mjek, farmacist, stomatolog, personel i mesëm mjekësor).

2. Komisioni pajis me licencë personat fizikë a juridikë, që plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

a. Të jetë i regjistruar në gjykatë si person fizik a juridik, ku të përcaktohet objekti përkatës i ushtrimit të veprimtarisë në fushën e shëndetësisë.

b. Të ketë leje higjieno-sanitare për mjedisin, ku do të ushtrohet veprimtaria, e shoqëruar me genplanin përkatës.

c. Të jetë anëtar i Urdhrit të Mjekëve (për mjekët dhe stomatologët).

Kriteret e veçanta, sipas llojit të licencës, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Kërkesa për licencim duhet paraqitur me shkrim, pranë sektorit të licencimit të veprimtarisë private, në Ministrinë e Shëndetësisë, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kërkesën me shkrim, së bashku me një vlerësim të shkurtër për veprimtarinë e kaluar dhe atë që do të ushtrojë subjekti fizik ose juridik.

b. Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person fizik a juridik.

c. Vërtetimin për anëtarësinë në Urdhrin e Mjekëve (për mjekët dhe stomatologët).

ç. Licencën profesionale të drejtuesit teknik të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë, (për subjektet juridike si klinika mjekësore, klinika dentare, depo farmaceutike) etj.

d. Deklaratën, ku të thuhet se subjekti fizik ose juridik njeh legjislacionin në fuqi, në fushën e shëndetësisë.

4. Llojet e licencave, që jepen nga komisioni i posaçëm, janë:

a. Licencë profesionale, individuale.

b. Licencë e shoqërisë, e cila jepet në bazë të licencës përkatëse profesionale të drejtuesit teknik.

5. Përbërja e komisionit të posaçëm i dhënies së licencave, ku bën pjesë edhe një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, si dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

6. Vendimi nr.500, datë 23.11.1992 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e shëndetësisë, në profesion të lirë privat”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano